



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

**Përmbajtja**

<b>1. PERSHKRIM I PERGJITHSEM .....</b>	<b>2</b>
<b>2. GJENDJA E RRJETIT KANALIZIMEVE NE PORTIN E DURRESIT .....</b>	<b>2</b>
<b>3. QELLIMI I PROJEKTIT .....</b>	<b>2</b>
<b>4. SPECIFIKIMET TEKNIKE.....</b>	<b>3</b>
Gropa Septike.....	3
<b>5. PREVENTIVI PA CMIME.....</b>	<b>6</b>

## **1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM**

Ndërtimi i godinës së re të zyrave modulare ka nevojë për shkarkimin e ujrave të ndotura. Meqënëse në kontratën e ndërtimit të këtij objekti nuk ishte parashikur lidhja me rrjetin e KUZ si dhe mungesa e KUZ në atë zonë të autoritet portual, lindi nevoja e ndërtimit / blerjes së gropës septike. Godina e re e zyrave modulare përbëhet nga afro 80 zyra të vogla modulare nga 2 persona në secilen zyrë (mes. 160 punonjës) dhe 100-150 vizitorë mesatarisht në ditë.

Autoriteti Portual Durrës synon që me anë të një Kontratë mallra, furnizim dhe vendosje të realizojë blerjen dhe vendosjen e një gropë septike me tre dhoma sipas nevojës së godinës si dhe të realizojë lidhjen e shkarkimit kryesor me këtë grope septike.

**O.E fitues**, do të jetë përgjegjes për furnizimin dhe vendosjen e e gropës septike sipas kërkesave të paraqitura më poshtë. Në këtë mënyrë, APD do të lidhe një kontratë me një operator të specializuar i cili do ti përgjigjet të gjitha nevojave për kryerjen e shërbimeve të kësaj procedure.

**Cilësia e materialeve dhe punimeve** të jenë të përshtatëshme, për kryerjen e veprimtarisë së kërkuar. Materialet të jenë efikas, duke garantuar një shfrytëzimin normal e në cdo kohë.

**Ndërhyrjet e furnizimit dhe vendosjes se gropes septike** të jenë të organizuara, të kontrolluara e me fleksibilitetin e duhur duke konsideruar dhe nevojat e Autoritetit Portual.

### **Ndërtimi i gropës septike do ketë si qëllim:**

- Reduktimin e ndotjes në territorin e portit dhe krijimin e kushteve sa më optimale për punën në zyrat e reja të Agjensive Doganore.
- Të sigurojë një trajtim me vëmendje dhe kujdesin e duhur të pronës së APD-së në tërësi dhe mjedisit.
- Të sigurojë përmirësimin në vazhdimësi të cilësive profesionale të personelit, të tij të mirëmbajtjes.

Për të arritur këto objektiva, APD-ja kërkon që operatori që do kryej shërbimin, të veprojë me cilësinë e një partneri real dhe me aftësitë e duhura për zbatimin e detyrave të ngarkuara sipas kësaj marrveshje.

Qëllimi i shërbimit që operatori ekonomik duhet të ketë të qartë është ai i furnizimit dhe instalimit i gropës septike sipas kushteve teknike.

## **2. GJENDJA E RRJETIT KANALIZIMEVE NE PORTIN E DURRESIT**

Rrjeti i kanalizimeve në territorin e portit është ndërtuar në vitin 2010 me material tuba polietileni. Sipas të dhënave që APD rrjeti i brendshëm nuk i mbulon të gjithë sipërfaqen e APD me rrjet kanalizimesh si rezultat i skemës dhe kuotave të shkarkimit.

## **3. QELLIMI I PROJEKTIT**

- Reduktimin e ndotjes në territorin e portit dhe krijimin e kushteve sa më optimale për punën në zyrat e reja të Agjensive Doganore.

## 4. SPECIFIKIMET TEKNIKE

### *Gropa Septike*

#### **Specifikime të përgjithshme**

Në zona ku nuk ka kanalizim lokal, domethënë nuk ka sistem të veçantë kanalizimi për zbrazjen e ujrave të ndotura duhet të ndërtohen gropat septike. Gropa septike bëhet për arsyt higjienike, parandalon përhapjen e sëmundjeve infektive në terren dhe përhapjen e aromave të pakëndshme. Në keto raste zakonisht ndërtohen gropat septike, si zgjidhje e shpejte dhe efikase. Gropat septike janë të materialeve të ndryshme si: Beton, plastike, metalike, kompozite etj. Gropat septike plastike ofrojnë një zgjidhje të përkryer dhe të shpejtë për të zgjidhur të gjitha problemet me gropat septike. Gropat septike plastike kanë shumë përparësi krahasuar me gropat klasike prej muri ose prej betoni. Më së shpeshti bëhen si rezervuarë horizontal plastik përkatësisht cisterna për ujrë dhe groposen në tokë. Përparësia e këtyre gropave është që janë të qëndrueshme ndaj uji. Gropat septike plastike vendosen shpejt dhe vëhen në funksion për një ditë, gjithçka mund të kryhet gjatë një dite. Në to mund të nguliten të gjitha llojet e konektorëve standard apo të tjerë. Përparësia e tyre më e madhe është që janë plotësisht të qëndrueshme ndaj të gjitha ndikimeve të ujrave nëntokësore agresive. Gropat septike plastike funksionojnë më së miri gjatë pranisë së lartë të ujrave nëntokësore sepse janë të qëndrueshme ndaj ujit edhe nga brenda edhe nga jashtë. Për këtë arsye janë të përsosura për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor të njeriut. Këto lloj depozitash nuk e humbin efektivitetin edhe nëse transportohen në të ardhmen në një pozicion tjetër. Bashkë me to mund të instalohet mini impiante trajtimi që derdhja përfundimtare të jetë ujë i pastër dhe ekologjik për mjedisin.

#### **Dimensionimi i gropës septike**

Për të eliminuar shkarkimin direkt të ujrave të zeza në terren (det, perrua apo fushë) për godinën, është parashikuar që të ndërtohen gropat septike para shkarkimit përfundimtar të tyre. Në permasimin e rezervuarit septik duhet të përcaktohen dy parametra themelore:

- dekantimi i lëndes organike në suspensë
- periodiciteti i zbrazjes së llumit të dekompozuar në rezervuarin septik

Përcaktimi i vëllimit të përgjithshëm të rezervuarit septik do të bëhet me anë të formulës:

$$V = \frac{QT}{0.7}$$

ku: V – vëllimi i përgjithshëm i rezervuarit (m<sup>3</sup>)

Q – prurja e ujrave të ndotura (m<sup>3</sup>/dite)

T – koha e qëndrimit të ujit në pjesën rrjedhëse e cila pranohet 1 – 3 ditë.

Prurja e ujrave të ndotura që hyjne në rezervuarin septik varet nga norma e përdorimit të ujit  $q$  në (l/dite/banor) dhe nga numri i banoreve të qëndrës së banuar  $N$ , pra:

$$Q = qN \text{ (m}^3\text{/dite)}$$

Periodiciteti i zbrazjes së rezervuarit septik nga llumi i dekantuar varet pikërisht nga sasia e llumit dhe praktikiteti dhe mund të variojë nga një herë në 3 muaj deri një herë në 1 apo 3 vjet. Në llogaritjet tona kemi pranuar kohën e zbrazjes së gropës septike 1 herë në muaj.

Kemi pranuar numrin e banoreve

- Per Zyra
- $N_{\max} = 250\text{-}300$  Punonjes dhe vizitore,
- normën e përdorimit  $q = 40$  l/dite/punonjes
- $T = 1.5$  dite dhe rrjedhimisht

#### PERCAKTI I PRURJEVE TE SHKARKIMIT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Sasia max	Norma l/dite	$Q_{\text{mes.dit}}$ m <sup>3</sup> /dite	$Q_{\text{mes.orare}}$ m <sup>3</sup> /ore	$q_{\text{mes.sek}}$ l/sek	Ko	$q_{\text{max.sek}}$ l/sek
3	Zyra	punonjes	250	300	40	12	0.583	0.162	2	0.32
Shuma						<b>12</b>	0.383	0.162		<b>0.32</b>

#### PERCAKTI I VELLIMIT TE GROPESE SEPTIKE

Nr.	Emertimi	Njesia	VELLIMI Gr.Septike m <sup>3</sup> /dite
1	Zyra	punonjes	12
Shuma			<b>12</b>

- vëllimi i gropës septike do të jetë:


$$V = 12 * 1.5 / 0.7 = 25.7 \text{ m}^3.$$

Pranojmë volumn total të gropës septike 27-30 m<sup>3</sup>.

Implant për purifikimin e ujrave të ndotura biologjik Kapaciteti / Volumi [m<sup>3</sup>] = 30,000 Lt Përdorimi në numer PE : 300 Persona NS [L/s] = 12.4 L/s Dimensionet e depozitës = 6550 x 2425 x 2700 Dimensioani i tubave [mm] = Ø160 (ose alternativ me kushtin që të plotësojë volumnin e kërkuar dhe nr e dhomave), Gropa duhet të jetë prej

polietileni, i cili është 100% i riciklueshëm dhe me brinjëzim për përforsim. Gropa septike ka të salduar me qafë teleskopike për instalim të shpejtë dhe të lehtë. Depozitat kanë tre kapak plastike me diametër 600 mm me një vulë dhe katër vida prej çeliku inox duke i bërë ato të papërshkueshme nga uji. Tubat hyrëse dhe dalëse mund të konfigurohen në DN160. Trashësia e murit të rezervuarit të variojë nga 8-14 mm për t'i dhënë rezervuarit ngurtësinë e tij.

Më poshtë po paraqesim në menyrë skematike një model gropa septike plastike:



## 5. PREVENTIVI PA CMIME

Objekti: Gropë Septike për zyrat e reja modulare pranë APD					
Nr.	Emertimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi (ALL)	Vlera (ALL)
	<b>Punime Germimi</b>				
1	Germim dheu me ekavator goma 0.25 m <sup>3</sup> ne kanale me gjersi deri 2 m ne toke te zakonshme kategoria III me shk ne toke	m <sup>3</sup>	30.7		-
2	Germim dheu ne prani te ujrave nentokesore mbi 1 thellesi me thellesi germimi H = 4.5 ÷ 5.5 m ( me perforcim me palakola Tip Larsen L604 n - 20 perdorime H.mes.pal = 15 m )	m <sup>3</sup>	71.7		-
3	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m <sup>3</sup>	47.9		-
4	Largim uji me sistemin ëell point gjatë gërmimit per godinen	orë	96.0		-
5	Mbushje ngjeshje me gur kave	m <sup>3</sup>	12.0		-
6	Shtrese betoni t=10 cm klase C 12/15	m <sup>3</sup>	2.6		-
7	Pastrim pusete kuz ekzistuese me makineri	cope	1.0		-
	<b>Shuma I</b>				-
	<b>Furnizim vendosoje gorpe septike me 3 dhoma</b>				
8	F.V. Impiant per purifikimin e ujrave te ndotura biologjik Kapaciteti / Volumi [m <sup>3</sup> ] = 30,000 Lt Perdorimi ne numer PE : 300 Persona NS [L/s] = 12.4 L/s , Dimensioni i tubave[mm] = Ø160	set	1.0		-
9	Instalim tuba drenazhi Ø125-110mm , pvc	ml	15.0		-
	<b>Shuma II</b>				-
	<b>Shuma I+II</b>				-
	<b>TVSH 20%</b>				-
	<b>Shuma A</b>	lekë			-